

VENDIM
ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME
Nr. 6, datë 15.04.2025

“PËR
ZMADHIMIN NË NATYRË TË KAPITALIT TË SHOQËRISË RDA PETROL
SH.A”

Në bazë të nenit 135 të ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar, të Statutit të shoqërisë aksionere RDA Petrol sh.a, Asambleja e Përgjithshme në mbledhjen e zhvilluar më datë 15.04.2025, në përfundim të mbledhjes, në mënyrë unanime,

VENDOSI:

1. Miratimin e zmadhimit të Kapitalit Themeltar në natyrë të shoqërisë aksionere RDA Petrol, nëpërmjet përfshirjes në të, të Pasurisë së Paluajtshme”:
 - Truall, me Nr.pasurie 14/13, Zona Kadastrale 8516, me sipërfaqe totale 10498.40 m², Kodi Unik 8516006147, Indeksi i hartës Kadastrale DR;I-13, me vendodhje në adresën: Bashkia Durrës.
2. Zmadhimin e Kapitalit Themeltar në natyrë të Shoqërisë në vlerën prej 119 627 118 Lekë (njëqind e nëntëmbëdhjetë milion e gjatëqind e njëzetë e shtatë mijë e njëqind e tetëmbëdhjetë), ku secili aksionar kontribuon në mënyrë të barabartë, pasi zotërimi i kësaj pasurie është ½ pjesë nga secili aksionar, si më poshtë:
 - Z. Fatjon Veizaj, zotërues i 50% të aksioneve të rregjistruar në kapitalin themeltar të shoqërisë kontribuon me ½ e vlerës së Pasurisë së Paluajtshme Nr.14/3, Zona Kadastrale 8516 (të cituar në pikën “1” të këtij vendimi). Vlera e pasurisë e rivlerësuar: 119 627 118 Lekë (njëqind e nëntëmbëdhjetë milion e gjatëqind e njëzetë e shtatë mijë e njëqind e tetëmbëdhjetë). Pra vlera e kontributit të tij është në shumën 59 813 559 (Pesëdhjetë e nëntë milion e tetëqind e trembëdhjetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e nëntë) Lekë.
 - Z. Kujtim Kale, zotërues i 50% të aksioneve të rregjistruar në kapitalin themeltar të shoqërisë kontribuon me ½ e vlerës së Pasurisë së Paluajtshme Nr.14/3, Zona Kadastrale 8516 (të cituar në pikën ”1” të këtij vendimi). Vlera e pasurisë e rivlerësuar: 119 627 118 Lekë (njëqind e nëntëmbëdhjetë milion e gjatëqind e njëzetë e shtatë mijë e njëqind e tetëmbëdhjetë).



Pra vlera e kontributit të tij është në shumën 59 813 559 (Pesëdhjetë e nëntë milion e tetëqind e trembëdhjetë mijë e pesëqind e pesëdhjetë e nëntë) Lekë.

3. Të miratojë ndryshimet në Statutin e Shoqërisë, në pjesën e kapitalit aksionar, i cili riformulohet si më poshtë:

- Kapitali i nënshkruar i Shoqërisë RDA Petrol sh.a nga 110.000.000 (njëqind e dhjetë million) Lekë rritet edhe me 119 627 118 Lekë (njëqind e nëntëmbëdhjetë milion e gjatëqind e njëzetë e shtatë mijë e njëqind e tetëmbëdhjetë) dhe bëhet 229 627 118 (dyqind e njëzetë e nëntë milion e gjashtëqind e njëzetë e shtatë mijë e njëqind e tetëmbëdhjetë) Lekë.
- Vlera nominale për aksion pas rritjes së kapitalit në natyrë, sa më sipër bëhet 1,000 Lekë/aksion.
- Zotërimi i aksioneve është si vijon:
 - i. Aksionari z.Fation Veizaj 114,813.559 aksione (50% të Kapitalit të Shoqërisë).
 - ii. Aksionari z.Kujtim Kale 114,813.559 aksione (50% të Kapitalit të Shoqërisë).

4. Ngarkohet Administratori i Shoqërisë për depozitimin e këtij Vendimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).

Ky vendim hyn menjëherë në fuqi.

Vendimi i Asamblesë përpilohet në dy kopje origjinale, në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet pa vërejtje nga të dy aksionarët e shoqërisë.

Miratoi:

AKSIONARËT E SHOQËRISË:

Fation VEIZAJ

Fation Veizaj
(Nënshkrimi)



Kujtim KALE

Kujtim Kale
(Nënshkrimi)